



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 07.11.2019, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Valbona Petrovci, e pavarur, Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sokol Berisha, i pavarur, Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Rifat Deri, i pavarur, dhe Baton Dushi (Nisma).

**Munguan:** Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Uran Ismaili (PDK) dhe Migjen Shala (PDK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Adonis Tahiri, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Shkumbin Gashi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë,

Faqe 1 nga 14

Valbona Osmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Arbresh Ajvazi dhe Visar Goxhufi, përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të e medjeve të shkruara dhe elektronike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit. Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Kryetari i Komunës, Shpend Ahmeti**, propozoi që në rend të ditës të hyjnë edhe këto pika: "Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, nr. 01/463/02-239184/2019, të dt. 30.09.2019, për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sylejman) Ramadanit"; "Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Komandantit legjendar Adem Jashari" dhe "Propozimvendimi për autorizim të borxhit".

**Egzon Azemi** tha se propozimi i kryetarit për vendosjen e shtatores së Komandantit legjendar Adem Jashari, është dashtë të silltet më herët, të paktën në mbledhjen e KPF-së, që grupet parlamentare me qenë të përgatitura për këtë propozimvendim, dhe një vendim i tillë me ardhur para seancës, tregon se kjo është krejtësisht jo serioze.

**Agim Gashi** theksoi se do të ishte mirë që ky propozimvendim të mbetet për shqyrtim në ndonjë nga seancat e radhës së Kuvendit, pasi që janë disa procedura. Pra, nëse mendojnë mirësjellje për një gjë të tillë, do t'i japim hapësirë Kuvendit që t'i analizojë të gjitha rrethanat për vendosjen e shtatores së Komandantit legjendar Adem Jashari.

**Leutrim Retkoceri** propozoi që kjo pikë të mos shtyhet, por të procedohet, pasi që është pikë e ndjeshme, kjo ndërlidhet me festë dhe nuk ka të bëjë me politikë nëse vendoset shtatorja e Adem Jasharit me rastin e festës 28 Nëntori.

**Halim Halimi** tha se çështja e këtyre pikave që po propozohen në momentin e fillimit të mbledhjes për të hyrë në rend të ditës, nuk është praktikë e mirë. Kjo praktikë po na përcjell me vite të tëra dhe është mirë që kjo të ndalet njëherë e përgjithmonë.

**Hafiz Krasniqi** tha se ky propozimvendim paraprakisht është dashtë të shqyrtohet më herët. Të diskutohet për shtatoren e Adem Jasharit para fillimit të mbledhjes, të vendoset për këtë brenda një minute, pa u ditur as struktura, as modeli, as pika se ku do të vendoset, besoj se nuk i bën nder kësaj pune, andaj kjo duhet të shqyrtohet ashtu si e meriton.

**Eman Rrahmani** lidhur me Propozimvendimin për autorizim të borxhit, theksoi se kjo kredi do të ishte e mirë sikur të ishte realizuar buxheti edhe të mos kishim pasur vitin e kaluar 25 milionë euro bartje të buxhetit dhe që sivjet mund ta kalojë shifrën më shumë se 35 milionë, atëherë kishte pasur arsye me u kërkuar një kredi e tillë, për shkak se destinimi i tyre është mjaft i nevojshëm edhe do të kishte përmirësuar ato karakteristika për të cilat u diskutua.



**Fiknete Bejta** sa i përket Propozimvendimit për autorizim të borxhit, tha se si projekt është i menduar mirë, andaj ne si asamblistë duhet të jemi më largpamës dhe duhet të votojmë për të mirën e qytetarëve të Prishtinës. Projekti është shumë i qëlluar dhe kredia është e mbulueshme.

**Sami Boroci** tha se involvimi i BERZH-it siguron edhe një lloj kredibiliteti të proceseve. Ky si projekt është jashtëzakonisht i mirë, sidomos pjesa e efijencës, pra është fond i ri me 15 milion euro, kështu që i bëj thirrje Kuvendit për ta votuar, sepse është një projekt nga i cili përfitojnë shumë qytetarët e Prishtinës.

**Kryesuesi** konstatoi se më 36 vota për dhe 1 abstenim, futet në rend të ditës për shqyrtim "Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 01/463/02-239184/2019, dt. 30.09.2019, për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sylejman) Ramadanit.

**Kryesuesi** konstatoi se më 36 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, futet në rend të ditës për shqyrtim "Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Komandantit legjendar Adem Jashari.

U konstatua se më 36 vota për dhe 3 abstenime, u miratua ky

#### **Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Informatë e Policisë së Kosovës rreth gjendjes së sigurisë në komunën e Prishtinës;
3. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2019 (TM3);
4. Propozimvendimi për anëtarësim të Komunës së Prishtinës dhe kuota e anëtarësisë në shoqatën "Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon";
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Feti (Hajredin) Gashit;
6. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2019 - 2020;
7. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Kuzhina Qendrore" SHA, në Prishtinë;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore;
9. Propozimvendimi për autorizim të borxhit;
10. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01-463/02-239184/19, të datës 30.09.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sylejman) Ramadanit;

11. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Komandantit legjendar Adem Jashari;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

#### **Pika e dytë**

**Informatë e Policisë së Kosovës rreth gjendjes së sigurisë në komunën e Prishtinës.**

Lidhur me gjendjes e sigurisë në komunën e Prishtinës, në pika të shkurta të pranishmit i informoi nënkolonel Arbnesht Ajvazi, shef i Operatives rajonale në Policinë e Kosovës.

**Agim Gashi** tha se policia është segmenti më i rëndësishëm i funksionimit të shtetit, të cilit duhet ta ndjej secili qytetarë. Kam kërkuar ta kemi këtë pikë të rendit të ditës, ku në veçanti do fokusohem tek një aksion i policisë në lagjen "Ulpiana" për veturat e parkuara në trotuare, ku brenda dy orëve kanë shpërndarë një mori tiketa të gjobave. Si këshilltar dhe si qytetar i Prishtinës, mendoj se aksionet e tilla nuk tregojnë kontinuitet të ndërtimit të vendit sa i përket sigurisë dhe kulturës së komunikacionit.

**Arbër Vokri** tha se do të ishte mirë që për këto të dhëna paraprakisht ta kemi edhe një raport në formë të shkruar, pra do të ishte e nevojshme që të jemi pak më të informuar për këto të dhëna që na u prezantuan. Po ashtu, zbatimi i Ligjit për kryeqytetin, që parasheh themelimin e Drejtorisë së Policisë së Kryeqytetit, dhe do të doja të dija se a kemi ndonjë pritshmëri se kur do të duhej të themelohej kjo drejtori.

**Adonis Tahiri**, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, tha se sa i përket formimit të Drejtorisë së Policisë së Kryeqytetit, çështja ka ngecur te aktet nënligjore, pra ligji është bërë, udhëzimet administrative jo, të cilat duhet të vijnë nga ministritë. Për themelimin e kësaj drejtorie, ne do t'i bëjmë kërkesë Qeverisë së re.

**Vlora Dumoshi** tha se Policia e Kosovës është një organ që heton rastet, por neve na duhet një parandalim, sidomos masat parandaluese para se të ndodhin, p.sh. kemi numër të madh të rasteve të dhunës në familje. Shqetësuese është edhe siguria e nxënësve nëpër shkolla, siç janë shfaqja e disa dukurive negative, si ajo e shpërndarjes së drogës, prandaj ne duhet t'i gjejmë masat parandaluese për këto dukuri të këqija.

**Shefki Gashi** ngriti shqetësim, duke cekur se gjuajtja me armë në dasma dhe ahengje të ndryshme është një dukuri tejet shqetësuese. Sa i përket krijimit të një drejtorie të policisë për kryeqytet, mendoj se kjo iniciativë nuk qëndron, pasi që kjo mund të ketë pasoja në nivel shtetëror, prandaj ajo duhet të ruhet si ushtri, hierarki policore, e cila vepron në tërë territorin e Kosovës.



**Leutrim Retkoceri** ngriti shqetësimin rreth sigurisë së nxënësve afër shkollave, duke thënë se ka disa raste kur fëmijët aksidentohen nga vozitësit e pakujdesshëm, që zhvillojnë shpejtësi të lartë në afërsi të shkollave, dhe për këtë kërkoj që të merren masa parandaluese, sidomos në kohën kur nxënësit hyjnë apo dalin nga shkolla. Po ashtu, është pak shqetësuese edhe mënyra e shqiptimit të tiketave dënuese për lënien e veturave në mënyra jo të rregullt.

**Egzon Azemi** tha se po të kishim raporte në formën e shkruar, kishim pasur mundësi edhe ne si asamblistë me i iniciuar disa kërkesa, që kishin ndikuar në ndalimin ose parandalimin e dukurive negative. Kisha kërkuar që, brenda mundësive, me na e sjellë me shkrim një raport të tillë, ku do të ishin specifikuar ato veprime negative, që vit pas viti i kishim vërejtur më mirë dallimet se ku po përkeqësohet dhe ku po përmirësohet gjendja në sigurinë publike në Prishtinë.

**Hafiz Krasniqi** shprehu mendimin se është pak më zhgënjyese pjesa e cila merret me dënimet në komunikacion, apo ekskluzivisht që bëhen për parkingjet e palejuara, mirëpo në këto rrethana besoj që edhe policia këtu duhet ta ketë një ndërgjegje pak si më të shtuar. Kjo gjendje besoj se është edhe në komunat tjera, ku ne as edhe mundësinë më të vogël nuk ia kemi krijuar qytetarit për parkingje të caktuara, ose mundësi të kryerjes së shërbimeve të caktuara të parkingut të nevojshëm.

**Drilon Pireva** tha se njëri prej problemeve që e vërejmë në trafik janë edhe rrethrotullimet, andaj kërkoj të di se çfarë masash janë marrë për t'u respektuar më shumë rregullat e komunikacionit në rrethrotullime. Po ashtu, sugjeroi që në raportet e radhës me pasur statistika të ndara edhe në baza gjinore.

**Rifat Deri** ngriti një shqetësim rreth prezencës së personave lëmshëkërkues, sidomos nëpër semaforë, ku ata nganjëherë janë edhe shqetësues për shoferët në komunikacion, dhe kërkoj të dijë se në kompetencë të kujt është rregullimi i kësaj fushe. Po ashtu, kërkoj të dijë arsyen e mosfunksionimit të mbikalimit të Rrethi i Flamurit.

Lidhur me vërejtjet, sugjerimet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha nënkolonel Arbresh Ajvazi, shef i Operativës rajonale në Policinë e Kosovës.

**U konstatua se u përkrah Informata e Policisë së Kosovës rreth gjendjes së sigurisë në komunën e Prishtinës.**

**Pika e tretë**

**Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2019 (TM3).**

**Agim Gashi** tha se ne si Grup parlamentar, e kemi analizuar TM 3-shin dhe sot jemi një muaj e më shumë me vonesë. Kjo vonesë disi e zbeh interesimin për trajtimin e materialit, kur ne e dimë që gjendja faktike buxhetore në Komunë sot është krejt ndryshe në krahasim me 30 shtatorin. Kjo praktikë është shumë e keqe. Vonesa kaq e madhe e një dokumenti

Faqe 5 nga 14

kaq të rëndësishëm, siç është raporti periodik 9-mujor, e humb seriozitetin e punës së Kuvendit dhe punës së Qeverisë.

Sa i përket të hyrave, mendoj se është arritur një realizim solid dhe në përputhshmëri me planifikimin, pra është realizim i kënaqshëm. Në fushën e arkëtimit të mjeteve hyrëse dominojnë të hyrat nga tatimi në pronë dhe lejet ndërtimore.

Sa i përket shpërndarjes së buxhetit dhe realizimit të tij, shihet njëfarë disharmonie në mes drejtorive, sepse kemi tri drejtori ku shpenzimet për këtë periudhë janë 0%, nga 145 kode buxhetore, në 89 kode buxhetore shpenzimi është zero, së paku në pasqyrat financiare të nëntëmujorit. Realizimi është shumë i ulët, kështu që ne si GP kemi një shqetësim, sepse shumë mjete do të na barten dhe asnjë parametër analizues nuk po na nxjerr nga situata.

**Mirsad Vitia** tha se ky raport flet më shumë për mospunën e kësaj qeverie dembele, sesa për përmbushjen e premtimeve të 2017-ës. Me këtë kabinet qeverisës, ky kryetar çdo vit e më tepër po dështon në realizimin e pritshmërive të banorëve të kryeqytetit.

Po thuajse në të gjitha drejtoritë komunale kanë qenë projekte të planifikuara, por pak mjete janë shpenzuar për realizimin e tyre. Duke filluar nga Drejtoria e Administratës, që kanë qenë 15 projekte të planifikuara, 10 nga to as që kanë filluar. Në drejtorinë e Parqeve 8 projekte të planifikuara, vetëm dy prej tyre kanë filluar të realizohen. Drejtoria e Investimeve Kapitale ka paraparë 33 projekte, 11 kanë filluar të realizohen, ndërsa 22 prej tyre kanë ngecur. Drejtoria e Shërbimeve Publike, nga 25 projekte të planifikuara, 16 nga to ende të pafilluara. Në Drejtorinë e Bujqësisë asnjë cent i shpenzuar. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka pasur 11 projekte për realizim, ku vetëm në tri prej tyre kemi investime. Drejtoria e Inspeksionit me 0% të realizimit të buxhetit. Po ashtu, edhe Drejtoria e Shëndetësisë për tri projektet kapitale, si "Ndërtimi i objektit të QKMF-së në Veternik", "Qendra për Autizëm" dhe "Digjitalizimi i institucioneve shëndetësore dhe sociale", ende nuk kanë filluar të realizohen. Edhe në Drejtorinë e Kulturës dhe të Sportit janë shpenzuar pak mjete për realizimin e projekteve të tyre.

Duke pasur parasysh të gjitha këto që u cekën, Grupi parlamentar i LVV-së nuk do ta votojë një raport të tillë, i cili pasqyron keq menaxhim të buxhetit nga ana e Komunës.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se ky raport financiar tremujor nuk jep shpresë se ka synim prioritet e rëndësishme të qytetarëve dhe nuk ka alokim të mjeteve financiare në përputhje me rrethanat dhe nevojat që ka Prishtina.

Performanca e të hyrave në krahasim me tremujorin e vitit të kaluar, është më e lartë për 28%, ndërsa performanca e shpenzimeve kalon në 30%.

Është për të ardhur keq se në raport nuk ka pasur asnjë cent të hyra nga licenca në biznese gjatë muajve korrik dhe shtator. Kjo dëshmon se në këta muaj nuk është hapur asnjë biznes i ri në kryeqytet, njëherësh kjo tregon edhe për kushtet apo lehtësimet që i ofron qeverisja komunale për të bërit biznes në Prishtinë. Po ashtu, edhe shpenzimet kapitale që janë në normë shumë të ulët, ani pse Prishtina ka shumë nevojë për realizimin e projekteve kapitale, e në raport del se vetëm 19% të buxhetit është shpenzuar, apo nga 48.3 milionë euro, janë shpenzuar vetëm 9.4 milionë euro.



Një pjesë të errët në këtë raport e zënë edhe detyrimet gjyqësore, ku Komuna ka humbur shumë lëndë në konteste gjyqësore dhe gjatë këtij viti detyrohet t'i paguajë më shumë se 22.8 milionë euro.

**Hafiz Krasniqi** tha se shikuar nga perspektiva e ofrimit nga dikasteri përgjegjës, flitet për një performacë pozitive, sidomos për të hyrat ku paraqesin një rritje prej 28.13%. Rritjet gjithashtu janë shprehur edhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, po kuptohet që performanca gjithmonë merret me realizimin e planit dhe planifikimit.

Duke pasur parasysh se në këtë tremujor, pra korrik-shtator 2019, janë realizuar të hyra prej 8 milionë e më shumë euro, ndërsa buxheti për vitin 2019 është paraparë të jetë prej 31 milionë e 733,984 euro, pra shihet që kemi një realizim prej 28.13%. Edhe përkundër konstatimit se jemi në suaza optimale të realizimit të të hyrave, vërehet se në disa projekte të planifikuara, sidomos te infrastruktura rrugore, kemi realizim të projekteve vetëm 19.72%, andaj shtrohet pyetja se ku është çështja që nuk realizohet.

Te pjesa dërmuese e dikastereve përkatës ku përcaktohet performanca pozitive, shihet se aty pikërisht kemi ngecje më të mëdha në shfrytëzimin e buxhetit. Është fjala për të gjitha dikasteret ku kanë të bëjnë me shfrytëzimin e buxhetit në investime kapitale, veçmas në infrastrukturë, në arsim, në kulturë, në shëndetësi, në bujqësi etj.

**Egzon Azemi** tha se ne kërkojmë që secili drejtor të përgjigjet për drejtorinë e vet, për punën apo mos punën e tyre, kështu që secili nga ata ta marrë përgjegjësinë e vetë, dhe i kisha lutur që të mos fshihen gjithmonë pas drejtoreshës së Financave.

**Vlora Dumoshi** ngrit një shqetësim, duke thënë se në këtë raport figurojnë punët që janë kryer, andaj drejtorët e drejtorive përkatëse duhet të referojnë për punët e kryera. Pra secili drejtor e ka për obligim të jetë këtu prezent dhe të na tregojë për punën në atë drejtori.

**Drilon Pireva** tha se ne duhet ta dallojmë raportin financiar nga ai i punës, andaj ne si asamblistë duhet me bërë dallimin mes raportit financiar dhe raportit të punës, kështu që ne përmes raportit financiar mundemi me bërë kritika për drejtorët e caktuar dhe me kërkuar punë më shumë, ose me kritikuar për mos realizim të projekteve.

**Vala Peshku** theksoi se disa nga anëtarët e Kuvendit po insistojnë që për projektet të cilat nuk janë pasqyruar në numra, së paku të jetë një listë e projekteve të cilat janë në punë e sipër. Por, ne asamblistët duhet ta hapim më shpesh portalin "Prishtinaonline", se aty janë të gjitha gjërat.

**Eman Rrahmani** tha se ne kot kërkojmë dokumente tjera shtesë rreth punëve të cilat janë kryer nga drejtoritë përkatëse, kur janë njerëzit mbrapa tyre që punojnë dhe nuk kanë asnjë përgjegjësi ligjore për mos punën e tyre! Andaj, unë mendoj që ky është një problem që nuk funksionon Komuna e Prishtinës, dhe kot kërkojmë dokumente, se kjo është përqindja e mos punës së tyre.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit rreth gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2019, sqarime të nevojshme dhanë Valbona Makolli, drejtoreshë, Genc Bashota, drejtor, Bujar Gashi, drejtor, dhe Adonis Tahiri, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për, 17 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2019 (TM3).

#### **Pika e katërt**

Propozimvendimi për anëtarësim të Komunës së Prishtinës dhe kuota e anëtarësisë në shoqatën "Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon".

Kryesuesi konstatoi se më 38 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendimi për anëtarësim të Komunës së Prishtinës dhe kuota e anëtarësisë në shoqatën "Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon".

#### **Pika e pestë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Feti (Hajredin) Gashit.

Kryesuesi konstatoi se më 37 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Feti (Hajredin) Gashit.

#### **Pika e gjashtë**

Informatë për fillimin e vitit shkollor 2019 - 2020.

Lidhur me Informatën për fillimin e vitit shkollor 2019-2020, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

Leonora Shabani - Bajraktari, tha se në këtë dokument në mënyrë sipërfaqësore jepen informatat mbi përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor 2019-2020, informata mbi zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, ngritjen dhe zhvillimin e bibliotekistëve të shkollave, ekipin profesional për mbështetjen e mësimitdhënësve, përgatitjen e planeve vjetore dhe dymujore të mësimitdhënësve etj. Gjithashtu na janë sjellë informata mbi regjistrimin e fëmijëve, nxënësve në institucione parashkollore dhe fillore, risistemimin e mësimitdhënësve, pajisjen e nxënësve në nivel fillor dhe të mesëm të ultë me tekste shkollore, si dhe informata lidhur me intervenimet në infrastrukturën shkollore, por në realitet shumë pak është investuar në infrastrukturën shkollore. Po ashtu, disa çerdhe ende nuk kanë filluar punën, e disa nga to ende nuk kanë filluar të ndërtohen.

Ky dokument, i sjellë në këtë formë, mendoj se nuk i plotëson standardin e raportimit për një fushë siç është arsimi në komunën tonë. Pra, veprimet dhe hapat e nevojshëm përgatitor, duket që nuk janë të mjaftueshëm për një fillim të mbarë të vitit shkollor.

Agim Gashi tha se bazuar në Ligjin për arsimin në komuna, Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Ligjin për arsimin parauniversitar, Komuna kryesisht ka kompetenca teknike, duke filluar nga krijimi i kushteve infrastrukturore dhe kushteve të tjera brenda institucioneve



dhe jashtë tyre, ndërtimin e marrëdhënieve profesionale përbrenda institucioneve, pranimin e punëtorëve dhe politikat e tjera që kanë të bëjnë me organizimin e mirë të procesit mësimor brenda institucioneve.

Sa u përket këtyre kompetencave ligjore të komunave, në Informatë kemi pak të dhëna, sepse për infrastrukturë nuk ka. Në këtë informatë nuk janë inkorporuar statistikat e përgjithshme që flasin për gjendjen në institucionet shkollore, duke u nisur prej nivelit më të ulët deri ai më i larti. Do të ishte mirë që në këtë dokument me u konstatuar edhe numri i nxënësve etj., prandaj informacionet duhet të jenë të sakta, të jenë në përputhshmëri me kompetencat ligjore, atëherë ne duhet të angazhohemi për t'i orientuar investimet në ndryshimin e gjendjes në arsim.

**Vlora Dumoshi** tha se para se të silleshin informata të tilla në Kuvend, do të duhej paraprakisht të shqyrtoheshin në Komitetin për Arsim, në kuptimin më të mirë, që me mundur me e plotësuar dhe me i begatuar më mirë informatat, apo qofshin edhe raporte.

**Halim Halimi** u shpreh se edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam theksuar se do të duhej të bëhej një raportim, një informatë për përfundimin e vitit shkollor, gjë që një informatë të tillë nuk e kemi. Është dashur gjithsesi të raportohet për përfundimin e vitit shkollor, njëkohësisht edhe për përgatitjet e vitit të ri shkollor. Në këtë informatë është dashtë të

jepen të dhënat se a kanë filluar të gjitha shkollat punën më 2 shtator, a kanë qenë objektet shkollore të përgatitura për pranimin e nxënësve, a kanë qenë në rregull etj.

Sa i përket infrastrukturës shkollore, shihet se në bazë të raportit që buxheti prej 2 milionë është harxhuar pak, pra shumë kohë duhet të kalojë për t'u shpenzuar ai buxhet, kështu që do të bartet buxheti për vitin e ardhshëm.

**Valbona Petrovci** kërkoi të dijë se cila është mënyra që do të mundësonte rritjen e numrit të psikologëve nëpër të gjitha shkollat, sepse e pakta çka ishte dashur me pasur, kishte qenë me pasur nga një psikolog secila shkollë. Së pari, gjithë këta fëmijë me autizëm dhe me nevoja të veçanta, por edhe fëmijët pa probleme të tilla sigurisht se kanë nevojë për psikolog.

**Shefki Gashi** ngriti një shqetësim rreth këtij raporti, duke thënë se sa i përket Komisionin për pranimin e punëtorëve të arsimit nëpër shkolla, disa nga shkollat që janë në periferi të Prishtinës, aty asnjë arsimtarë nuk është pranuar qe pesë vjet nga njerëzit që jetojnë në atë lokalitet, por janë sjellë njerëz nga komunat tjera, si Kamenica, Vitia, Kaçaniku etj., andaj do të ishte mirë që kjo çështje të merret parasysh nga Drejtoria e Arsimit.

Lidhur me pyetjet, vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit.

**U konstatua se u përkrah Informata për fillimin e vitit shkollor 2019 - 2020.**

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë.**

**Halim Halimi**, për anëtar të Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Kuzhinën Qendrore" nga radhët e LDK -së, e propozoi Mustafë Krasniqin.

**Vala Peshku**, për anëtar të Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Kuzhinën Qendrore" nga radhët e PSD-së, e propozoi Fiknete Bejtën.

**Leonora Shabani - Bajraktari**, për anëtar të Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Kuzhinën Qendrore" nga radhët e LVV-së, e propozoj Egzon Azemin.

**Florida Canolli**, për anëtar të Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Kuzhinën Qendrore" nga radhët e PDK-së, e propozoi Leutrim Retkocerin.

Kryesuesi konstatoi se nga votimi doli ky rezultat: Mustafë Krasniqi, 29 vota për, Fiknete Bejta, 24 vota për, Egzon Azemi, 19 vota për dhe Leutrim Retkoceri, 17 vota për.

Anëtarë të Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë, u caktuan Mustafë Krasniqi dhe Fiknete Bejta.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Vendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Kuzhina Qendrore", SHA, në Prishtinë.

#### **Pika e tetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore.**

**Arbër Vokri** tha se edhe ne jemi për vendosjen e kësaj pllake përkujtimore, por njëherësh është edhe kërkesë e shoqatave të shqiptarëve të dëbuar nga viset në veri përtej kufirit të Kosovës, konkretisht të muhaxhirëve të shekullit XIX, të dëbuar gjatë viteve 1877/78, një pjesë e konsiderueshme e të cilëve janë vendos në qytetin tonë, që edhe sot e kanë lagjen e tyre, me emrin "Lagjja e Muhaxhirëve". Kërkoj nga Kuvend që në njërin nga mbledhjet e radhës, ta cakton një lokacion për vendosjen e një monumenti të tillë.

**Vlora Dumoshi** tha se sa i përket vendosjes së një pllake përkujtimore për "Lagjen e Muhaxhirëve", do të ishte mirë që ajo pllakë të vendoset në Parkun e qytetit, pasi që edhe ai park i takon asaj lagjeje.

Lidhur me caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", sqarime të nevojshme dha Genc Bashota, drejtor.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e "Murit të Nderit", kushtuar sakrificës vetëmohuese të shqiptarëve të Kosovës për të shpëtuar hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

#### **Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për autorizim të borxhit.**



Egzon Azemi tha se ne nuk do ta votojmë këtë propozimvendim dhe, në shenjë pakënaqësie, LVV në momentin e votimit të këtij propozimvendimi do ta lëshojë sallën.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për dhe 7 kundër, u miratua Vendimi për autorizim të borxhit.

#### **Pika e dhjetë**

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-463/02-239184/19, të datës 30.09.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sylejman) Ramadanit.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-463/02-239184/19, të datës 30.09.2019, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Alban (Sylejman) Ramadanit.

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Komandantit legjendar Adem Jashari.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së Komandantit legjendar Adem Jashari.

#### **Pika e dymbëdhjetë**

**Pyetje dhe përgjigje.**

**Arbër Vokri për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe drejtoreshën e Drejtorisë së Administratës.**

-Punëtorët që e bëjnë sigurimin e jashtëm të objekteve të shëndetësisë primare, kanë ngecje në ekzekutimin e pagave dhe po ankohen që ka shumë raste që një pagë nuk ua japin fare gjatë vitit. Po ashtu, edhe kësaj radhe ka pasur vonesë të madhe, andaj kisha dashur të dijë se a ka ndonjë përparim në këtë drejtim.

- Disa objekte banesore në lagjen "Dardani" kanë nevojë për ndërhyrje nga Komuna, konkretisht në bodrumet e ndërtesave të kompleksi "Santea", që shpesh mbushen me ujë, ku dhe rrezikohet edhe konstrukt i ndërtesave.

- Kur do të mbahen zgjedhjet në bashkësitë lokale të Komunës së Prishtinës?

**Bujar Gashi, drejtor,** tha se sigurimin fizik të objekteve shëndetësore e bëjnë kompanitë private, që bëhet përmes tenderimit. Për shkak të përfundimit të mjeteve në kontratën e kaluar, na është dashtë ta bëjmë një kontratë shtesë për tre muaj. Buxhetin të cilin e kemi pasur, nuk ka qenë shumë i madh që kemi mundur me bërë dhe është bërë për tre muaj, deri në realizimin e kontratës kryesore, që tani është një kontratë në nivel të Komunës, nuk është e ndarë nëpër sektorë.

Arsyeja pse kanë mbetur të papaguar, ose janë paguar pjesërisht me gjysmë page në muajin shtator, ka qenë se në buxhetin që e kemi pasur kanë qenë vetëm 4500 euro që na kanë mbetur, ndërsa procedurat e prokurimit kanë zgjatë për lidhjen e kësaj marrëveshje së negociuar me të njëjtin operator ekonomik sipas Ligjit të prokurimit.

**Arbër Vokri** tha se do të mendojmë për ta iniciuar procedurën drejt themelimit të një ndërmarrje publike, e cila do ta kryente sigurimin e objekteve, jo vetëm të shëndetësisë primare, por edhe të të gjithave ku ka kontraktorë privat. Pikërisht për këtë arsye, por edhe për arsye të tjera, mendoj që edhe kjo do të jetë një prej temave në njërin prej mbledhjeve të ardhshme të Kuvendit.

**Jeta Rafuna - Hasani, për drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës dhe drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit.**

-Çka është duke ndodhur me shtëpinë e Shkollës së parë shqipe, e cila ka filluar të rehabilitohet dhe është ndaluar puna?

-Deri ku ka mbërri procedura rreth rindërtimit, apo të ndërtimit për shtëpinë të Shkollës së Herticëve”?

**Blerta Basholli, drejtoreshë,** tha se për Shkollën e parë shqipe, si fazë e parë, e kemi pasur pastrimin e shkollës dhe kjo ka përfunduar, kështu që ka qenë e planifikuar vetëm pastrimi. Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë është duke e bërë projektin dhe ideja ka qenë që me vazhduar në konservim, mirëpo jemi duke e diskutuar në nivel komunal se çka të bëjmë me atë, për shkak se është pronë private.

Sa i përket Shkollës së Herticëve”, janë hapur tenderët për konkurs projektim dhe jemi në pritje të formimit të një komisionit, ku do ta zgjedhim një komision sa më të mirë, në mënyrë që me u zgjedhur projekti më i mirë i mundshëm.

**Sami Salihu, për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit dhe drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.**

-Prindërit e nxënësve të shkollës fillore “Meto Bajraktari”, kërkojnë nga kjo drejtori që ta bëjnë zëvendësimin e bankave dhe karrigeve, pasi që ato janë shumë të amortizuara, gjë që e rrezikojnë edhe jetën dhe shëndetin e nxënësve.

-Banorët afër rrugës “Shkumbini”, në lagjen “Kalabria”, kërkojnë që të bëhet ndriçimi i kësaj rruge.

**Mirsad Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

Banorët afër rrugës “Shkëndija” në Hajvali kanë bërë kërkesë përmes përfaqësuesit të asaj zone, z. Florim Sinani, ku kërkojnë që sa më parë të bëhet sanimi i ujërave të zeza në atë rrugë. Tash e 5-6 muaj këto ujëra kanë dalë mbi sipërfaqen e rrugës dhe janë pengesë për ata qytetarë.

Edhe banorë afër rrugës “Bejtë Vitia” në Hajvali, kërkojnë që ujërat e zeza të futen nëpër gypa dhe të mbulohen, si dhe ura të bëhet më e qasshme nga ato ujëra.



**Kushtrim Sopa, për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, drejtorin e Drejtorisë së Sportit, drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit:**

1. A do të ndriçohet komplet lagjja, rrugët kryesore dhe dytësore mbi ish-tjegulloren në Prishtinë?
2. Masat e ndërmarra nga Policia e Kosovës për lirim të trotuareve nëpër lagje, duke i dënuar qytetarët, të cilët nuk kanë asnjë zgjidhje tjetër për vendparking, a ka mundësi të rishikohet në raste kur familjet prishtinase i parkojnë ato para pragut të shtëpisë, dhe në mungesë të hapësirës, me qindra metra, madje edhe kilometra larg i dërgojnë vetura për t'iu shmangur dënimeve eventuale?
3. A do të rregullohet dhe kur do të rregullohet Palesta e madhe në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve, ngase tani po bëhen 20 vjet nga djegia e saj dhe ende mbetet e pashfrytëzueshme për destinimin që kishte, pra për sport?
4. A do të vendoset ndriçimi aty ku nuk ka, si në lagjen "Dardania", te "Kurrizi"?
5. Çka është duke u bërë me pronat sportive (stadiumet) që ju ka skaduar kontrata e shfrytëzimit, sepse e kemi rastin në Bardhosh, që këtë stadium e ka në shfrytëzim që 10 vjet z. Fadil Arifi, vëllai i Avni Arifit dhe kushëri i drejtorit aktual të Sportit?  
Ky stadium që 10 vjet nuk është shfrytëzuar nga banorët lokal.
6. A do të ndriçohet rruga "Qemajl Stafa", në lagjen "Arbëria", mbrapa varrezave, në Prishtinë?
7. Në rrugën "Avdyll Lahu", te Varrezat e Jahudive, banorëve po iu shfaqen tufa të mëdha qensh, si dhe gjarpërinj, me dhjetëra raste.  
- A do të merren masa për evitimin e fatkeqësive eventuale nga kjo problematikë? Kjo është hera e tretë, apo katërt që ju drejtohem, duke e paraqitur shqetësimin e qytetarëve të kësaj lagjeje dhe ende nuk janë marrë masa, edhe pse është premtuar për një gjë të tillë.
8. Shqetësime dhe kërkesa nga banorët e lagjes "Arbëria":  
- "Policët e shtrirë" që kanë qenë tek shkolla "Model" janë shkatërruar pothuajse tërësisht, të ndërrohen ose të rregullohet ajo pjesë, ngase gropat dhe hapësirat e krijuara në rrugë po krijojnë rrezik për prishje të veturave që qarkullojnë në atë rrugë.  
- Në rrugën "Ahmet Dërguti" të vendosen "policë të shtrirë";  
- Në të njëjtën rrugë, "Ahmet Dërguti", të futet një autobus në qarkullim (e vetmja lagje që nuk ka autobus brenda lagjes).
9. Kërkesa për pjesë të ndryshme të qytetit:  
- Rregullimin urgjent të sallës së edukatës fizike të SHMU "Naim Frashëri";  
- Rregullimi i trotuareve në rrugën "Agim Ramadani", sidomos mbyllja e vrimave në vendkalime, ku shumë qytetarë janë lënduar;  
- Mbyllja e furrave të bukës, të cilat përdorin lëndë kancerogjene, sidomos furra e bukës në lagjen "Dardania", rruga "Mustafa Venhari";

- Kompania "Termokos", bën hapjen e kanaleve për shtrirjen e gypave, më pas ato kanale nuk mbyllen dhe asfalti mbetet i prishur;

- Kompania e ujësjellësit me muaj nuk sanon prishjet e ujit të pijshëm në lagjen "Dardania", afër vullkanizerit "Tip Top", ose te "Bas Trade" po në këtë lagje;

10. Ripërsëritje e pyetjes për herë të tretë për shqetësimin e qytetarëve:

Në pjesën periferike të lagjes "Arbëria", ndryshe e njohur si Përroi i Njelmët, fabrika e cila bënë riciklimin e letrës, mbetjet ose mbeturinat e saj i ka hedhur në përroskë, e cila përmbante ujë natyral, ndërsa tani hedhja e këtyre materialeve po shkakton dëme të mëdha ekologjike në atë pjesë. (Qytetarët e kësaj pjese të qytetit, 4 herë kanë dorëzuar ankesat e tyre edhe me nënshkrime, mirëpo si duket kanë hasur në veshë të shurdhër!).

- A do të merren masa urgjente për këtë shqetësim të qytetarëve të Përroit të Njelmët.

Mbledhja përfundoi në orën 15:40.

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Agim Kuleta**



Faqe 14 nga 14